

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8387
E martë, 15 shtator 2026
Çmimi 0.50 €

**PDK-ja dorëzon në
Kushtetuese lëndën për
konstituimin e Kuvendit,
kërkon masë të
përkohshme** | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

**"LIRIA KA EMËR" KA HAPUR KONFERENCËN KOMBËTARE "LUFTA PËR UÇK-NË": PO
NISIM NJË DIALOG TË BRENDSHËM PËR VLERAT E VËRTETA TË LUFTËS ÇLIRIMTARE**

LUFTA E UÇK-së ËSHTË E VETMJA LUFTË ÇLIRIMTARE E CERTIFIKUAR NGA NATO-ja



Në prag të shpalljes së verdiktit final nga Dhomat e Specializuara në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, po mbahet konferenca kombëtare "Lufta për UÇK-në", e organizuar nga platforma qytetare "Liria ka emër". Në

panelin e parë, Enver Hasani, Ylber Hysa dhe Enver Hoxhaj kanë shtjelluar temën "Konteksti i ri i krijuar nga Dhomat e Specializuara". Ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj, ka theksuar se lufta e popullit tonë për liri përfundoi më 12 qershor 1999, ndërsa lufta

diplomatike u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë më 2008. "Lufta e UÇK-së është e vetmja luftë çlirimtare e certifikuar nga NATO-ja. Dhe e vetmja drejtësi e pranuar është lirimi i plotë i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimi i tyre në Kosovë!", ka thënë ai

**KURTI NË
MBLEDHJEN E PARË
TË QEVERISË BËN
THIRRJE PËR
BASHKËPUNIM
PËR ZGJEDHJEN E
PRESIDENTIT TË RI** F. 5



**HASANI:
KUVENDI
ËSHTË
KONSTITUAR
NË SHKELJE TË
KUSHTETUTËS** F. 5



**BQK-ja FORCON RRJETIN E SIGURISË
FINANCIARE TË KOSOVËS PËRMES
QASJES NË MEKANIZMIN
E AVANCUAR EUREP TË BQE-së** F. 8

**TRANSPORTI AJROR DHE
TELEFONIA NË RRIJTJE, BIE NUMRI
I UDHËTARËVE NË HEKURUDHA
GJATË KORRIKUT** F. 8

SPORT



**ZHEGROVA IA BËN SEFTE ME
JUVENTUSIN** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja PARALAJMËRON SERBINË PËR AFRIMIN ME KINËN NË FUSHËN E IA-së

UASHINGTON, 14 SHTATOR - E ardhmja e mundësive ekonomike të Serbisë do të varet nga vendimet politike dhe zgjedhjet e partneriteteve që ajo bën sot, paralajmëron Departamenti Amerikan i Shtetit në një koment për Radion Evropa e Lirë, lidhur me afrimin gjithnjë e më të madh të Serbisë me Kinën në fushën e inteligjencës artificiale (IA). Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian rikujton se harmonizimi me rregullat e Bashkimit Evropian në fushën e inteligjencës artificiale është pjesë e procesit më të gjerë të integritetit evropian. “Si pjesë e procesit të anëtarësimit, Serbia është zotuar ta harmonizojë legjislacionin e saj me këto rregulla”, tha një zëdhënës i Komisionit Evropian për REL-in. Nga Instituti i BE-së për Studime të Sigurisë thonë për REL-in se integrimi më i thellë me ekosistemet teknologjike kineze mund ta ndërlikojë harmonizimin e mëvonshëm me kërkesat e Brukselit në rrugën evropiane të Serbisë. Serbia është kandidate për anëtarësim në BE që nga viti 2012. Gjatë muajve të fundit ajo është afruar ndjeshëm me Kinën në fushën e inteligjencës artificiale përmes nënshkrimit të marrëveshjeve në nivelin më të lartë. Por, Kina nuk është e vetmja e interesuar për bashkëpunim me Beogradin zyrtar në këtë fushë. Inteligjenca artificiale ishte një nga temat edhe gjatë vizitës së presidentit francez Emmanuel Macron në Serbi në gusht të vitit 2024.

Çfarë nënshkroi Vuçiqi me Xi Jinpingun?

Në maj, në prani të presidentit të Serbisë dhe të Kinës, Aleksandar Vuçiq dhe Xi Jinping, në Pekin u nënshkrua një memorandum për bashkëpunimin mes dy vendeve në fushën e inteligjencës artificiale. Dy muaj më vonë, në korrik, përfaqësuesit e 29 vendeve, përfshirë Serbinë, nënshkruan në Shanghai marrëveshjen për themelimin e Organizatës Botërore për Bashkëpunim në fushën e Inteligjencës Artificiale (WAICO). Nga vendet evropiane, nënshkruese janë vetëm Rusia dhe Bjellorusia. Shumica e vendeve nënshkruese janë nga Azia dhe Afrika, ndërsa organizatës më vonë iu bashkua edhe Irani. Marrëveshjet vijnë në kohën kur Serbia po përpqet ta përshejtojë zhvillimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e inteligjencës artificiale. Në fillim të vitit 2025 Qeveria e Serbisë miratoi Strategjinë e re për Zhvillimin e Inteligjencës Artificiale deri në vitin 2030, e cila parasheh investime shtesë në kërkime, infrastrukturë kompjuterike dhe përdorimin e sistemeve të

inteligjencës artificiale në sektorin publik. Zyra për Teknologji të Informacionit dhe Qeverisje Elektronike e Serbisë nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë lidhur me marrëveshjet e nënshkruara dhe nëse inteligenca artificiale kineze do të përdoret në institucionet shtetërore. REL-it nuk iu mundësua as qasja në memorandumin e nënshkruar.

Çfarë dihet për marrëveshjet me Kinën?

Memorandumi i mirëkuptimit për avancimin e bashkëpunimit në fushën e inteligjencës artificiale u nënshkrua në Pekin në maj. Në emër të Serbisë nënshkroi Mihajlo Jovanović, drejtor i Zyrës për Teknologji të Informacionit dhe Qeverisje Elektronike të Serbisë. Nga pala kineze, dokumenti u miratua zyrtarisht nga Komisioni Kombëtar për Zhvillim dhe Reforma i Kinës (NDRC). “Bashkëpunimi mes Serbisë dhe Kinës në fushën e teknologjive moderne, përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën dhe inovacionet digjitale, përbën një nga segmentet më dinamike dhe më premtuese të marrëdhënieve të përgjithshme dypalëshe dhe një bazë të rëndësishme për lidhjen e mëtejshme të kapaciteteve kërkimore-shkencore dhe teknologjike të të dyja vendeve”, tha atëkohë Jovanović. Sipas njoftimit që bëri Agjencia për Zhvillim e Serbisë pas vizitës së Vuçiqit në Kinë, gjatë saj u nënshkruan më shumë se 30 marrëveshje dhe memorandum. Në njoftim thuhej gjithashtu se Serbia shihet si një qendër e mundshme rajonale “për investimet kineze në industri, logjistikë dhe zhvillim teknologjik”. Në korrik, Serbia bëri një hap tjetër drejt afrimit me Kinën në këtë fushë, kur në Shanghai u themelua WAICO - Organizata Botërore për Bashkëpunim në fushën e Inteligjencës Artificiale. Një muaj më herët, Qeveria e Serbisë kishte miratuar vendimin për lidhjen e marrëveshjes për themelimin e kësaj organizate, me çka ky vend mori zyrtarisht statusin e një prej shteteve themeluese. Nismën për krijimin e saj Kina e kishte paraqitur një vit më parë, duke paralajmëruar se inteligenca artificiale mund të shndërrohej në privilegj të një numri të vogël shtetesh dhe kompanish, nëse në nivel global nuk krijohet një bashkëpunim më i gjerë në fushën e teknologjive të avancuara. Përmes anëtarësimit në këtë organizatë, Serbia, ndër të tjera, do të ketë qasje falas në modele të inteligjencës artificiale me burim të hapur (open-source), do të mund ta përdorë teknologjinë kineze të inteligjencës artificiale si alternativë më të lirë ndaj zgjidhjeve



më të kushtueshme të kompanive teknologjike perëndimore si dhe do të ketë mundësi t'i trajnojnë ekspertët e saj në Kinë përmes një fondi të paralajmëruar bursash.

ShBA-ja i bën thirrje Serbisë të zgjedhë “burime të besueshme”

Departamenti Amerikan i Shtetit nuk deshi të komentojë drejtpërdrejt afrimin e Beogradit zyrtar me Pekinin në fushën e inteligjencës artificiale, por theksoi se është e qartë se cilën anë duhet ta zgjedhë Serbia. “Shtetet e Bashkuara e inkurajojnë Serbinë ta zhvillojë potencialin e saj të plotë - dhe të garantojë sigurinë e saj kombëtare - duke zgjedhur burime dhe furnizues të besueshëm të pajisjeve dhe teknologjisë së inteligjencës artificiale, si dhe partnerë të besueshëm, si Shtetet e Bashkuara”, thuhet në përgjigje. Departamenti i Shtetit rikujtoi gjithashtu se ShBA-ja është lidere në teknologjinë e inteligjencës artificiale dhe përfaqëson standardin më të lartë për teknologjinë që është “zhvilluar në mënyrë të përgjegjshme, bazuar në transparencë dhe pa paragjykitime ideologjike dhe manipulime të imponuara nga autoritetet”. “Kur vendet miratojnë sistemet amerikane të inteligjencës artificiale, ato nuk blejnë infrastrukturë vetëm si konsumatorë - ato hapin mundësi inovative për ekonominë dhe qytetarët e tyre”, thuhet në përgjigjen e Departamentit Amerikan të Shtetit. ShBA-ja, prej kohësh, mban qëndrimin zyrtar se zhvillimi i inteligjencës artificiale nga Kina mund të ndihmojë në modernizimin e ushtrisë dhe të kapaciteteve të saj të mbikëqyrjes. Për këtë arsye, Uashingtoni ka vendosur kontrolle gjithnjë e më të rrepta të eksporteve. Në vitin 2022 Departamenti Amerikan i Tregtisë vendosi kufizime që ia ndalojnë Kinës qasjen në çipat më të avancuar për inteligjencën artificiale, teknologjitë për superkompjuterë dhe pajisjet për prodhimin e gjysmëpërçuesve të avancuar, duke i arsyetuar këto masa me nevojën për mbrojtjen e sigurisë kombëtare të ShBA-së.

Çfarë i rikujton Brukseli Serbisë?

Komisioni Evropian thotë për Radion Evropa e Lirë se Serbia është zotuar të harmonizohet me rregullat e Brukselit, përfshirë komizën evropiane për rregullimin e inteligjencës artificiale dhe Aktin e BE-së për Inteligjencën Artificiale (AI Act). Komisioni shpjegon se rregullat e BE-së nuk vlejnë vetëm për kompanitë me seli brenda bllokut, por edhe për ofruesit e sistemeve dhe modeleve të inteligjencës artificiale që operojnë në tregun e BE-së, përfshirë kompanitë nga vendet e treta. BE-ja, prej kohësh, synon të pozicionohet si një prej rregullatorëve kryesorë globalë në fushën e inteligjencës artificiale, duke vënë në plan të parë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kontrollin e rreptë të rreziqeve. Përmes Aktit për Inteligjencën Artificiale (AI Act), i cili nisi të zbatohet në gusht të këtij viti, Brukseli synon të sigurojë që teknologjitë e avancuara të zhvillohen në përputhje me standardet demokratike, transparencën dhe mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve. Në përgjigjen e Institutit të BE-së për Studime të Sigurisë, të nënshkruar nga analistët Bojana Zoriq dhe Clotilde Bomon, thuhet se partneriteti në fushën e inteligjencës artificiale, në vetvete, nuk përbën shkelje të detyrimeve të Serbisë në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Megjithatë, ai ngre pikëpyetje të reja për orientimin strategjik të Beogradit. “Për BE-në, shqetësimi kryesor është se Serbia gradualisht po integrohet në ekosisteme teknologjike dhe të qeverisjes që mund të dallojnë nga ato evropiane. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi harmonizimi i Serbisë me politikën e përbashkët tashmë është i paplotë dhe larg nivelit të kënaqshëm”, paralajmërojnë nga Instituti. Ato rikujtojnë teknologjinë Huawei Safe City, tashmë të përdorur në Serbi, dhe thonë se zbatimi i saj ka ngritur shqetësime për mundësinë e mbikëqyrjes masive dhe sigurinë e të dhënave - çështje që inteligenca artificiale i ndërlikon edhe më tej. “Kombinimi i inteligjencës artificiale

me të dhëna të ndjeshme, infrastrukturën e mbikëqyrjes dhe varësinë nga furnizuesit e jashtëm, rrit rreziqet për sigurinë kibernetike dhe spiunazhin dhe i bën cenueshmëritë sistemeve”, vlerësojnë nga Instituti. Zoriq dhe Bomon konsiderojnë se ekziston rreziku i krijimit të varësisë teknologjike nga Kina. “Varësia krijohet kur i njëjti ekosistem teknologjik, gradualisht, ofron infrastrukturën, harduerin, kapacitetet ‘cloud’ ose kompjuterike, softuerin, modelet e inteligjencës artificiale dhe ekspertizën teknike. Kur këto shtresa ndërliken, kalimi në një sistem tjetër bëhet i kushtueshëm dhe politikisht i vështirë”, shpjegojnë ato. Zoriq dhe Bomon vlerësojnë se BE-ja duhet t'i ofrojë gjithë Ballkanit Perëndimor alternativa ndaj integritetit me Kinën në fushën e inteligjencës artificiale, “duke lehtësuar qasjen në kapacitetet kompjuterike evropiane dhe programet kërkimore, si dhe duke rritur mbështetjen dhe investimet në sigurinë kibernetike”.

Bashkëpunimi Kinë - Serbi në fushën e inteligjencës artificiale

Bashkëpunimi mes Serbisë dhe Kinës në fushën e inteligjencës artificiale nisi të rritej që në vitin 2019, kur Zyra për Teknologji të Informacionit dhe Qeverisje Elektronike e Serbisë nënshkroi në Shanghai një memorandum me gigantin teknologjik kinez “Huawei” për krijimin e një platforme kombëtare për zhvillimin e inteligjencës artificiale. Dy vjet më vonë, më 2021, Serbia themeloi Institutin për Inteligjencë Artificiale, ndërsa në Qendrën Shtetërore të të Dhënave në Kragujevc vazhdoi zhvillimi i platformës kombëtare të inteligjencës artificiale, të bazuar në infrastrukturën dhe teknologjitë për të cilat ishte aritur marrëveshje më herët me “Huawei”-n. Deri te memorandumit i fundit dhe anëtarësimi në organizatën globale nuk kishte hapa të tjerë konkretë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në këtë fushë. Vitet e fundit të dyja vendet kanë shtuar bashkëpunimin në fushën e teknologjive digjitale, telekomunikacionit, inteligjencës artificiale dhe robotikës. Ky bashkëpunim është veçanërisht i dukshëm përmes partneritetit shumëvjeçar mes institucioneve shtetërore serbe dhe kompanisë “Huawei” e cila ndodhet në listën e zezë të ShBA-së. Hapi i fundit që i ka afruar edhe më shumë dy vendet në fushën e teknologjisë, është hapja, më 29 gusht, e një fabrike të robotëve humanoidë në Shabac, në përfundim të Serbisë. Robotët e prodhuar aty pritet të eksportohen në Bashkimin Evropian.

PDK-ja DORËZON NË KUSHTETUESE LËNDËN PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT, KËRKON MASË TË PËRKOZHSHME

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar të hënën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve dhe procedurave që lidhen me konstituimin e Legjislaturës XI të Kuvendit.

Kërkesa është dorëzuar nga kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Arian Tahiri, deputeti Përparim Gruda dhe avokati Faton Fetahu.

Kryetari i grupit parlamentar, Arian Tahiri, tha se PDK-ja po e dërgon sot këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese për të marrë një përgjigje përfundimtare për shkeljet që, sipas saj, kanë përcjellë procesin e konstituimit të Kuvendit. “Sot po e dorëzojmë në Gjykatën Kushtetuese këtë lëndë, sepse pas gjithë asaj që ka ndodhur në Kuvend, është e domosdoshme që institucioni më i lartë i interpretimit të Kushtetutës ta thotë fjalën e vet. Kushtetuta dhe rendi kushtetues nuk mund të varen nga kalkulimet politike të askujt”, tha Tahiri.

Deputeti Përparim Gruda theksoi se kërkesa e PDK-së ka për qëllim rikthimin e funksionimit institucional mbi bazën e Kushtetutës. “Ne po kërkojmë rikthimin e rendit kushtetues, jo vendosjen e rendit të Vetëvendosjes. Në Republikën e Kosovës rregullat i përcakton Kushtetuta, jo vullneti politik i një partie dhe as interpretimet që ndryshojnë varësisht prej interesit të momentit”, deklaroi Gruda.

Ndërkaq, avokati Faton Fetahu bëri me dije se, krahas kërkesës kryesore, është kërkuar edhe vendosja e një mase të menjëhershme të përkohshme. “I kemi kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të vendosë menjëherë masë të përkohshme, në mënyrë që të parandalohet prodhimi i pasojave të mëtejshme juridike dhe institucionale nga një proces, kushtetutshmëria e të cilit tashmë është kontestuar para Gjykatës. Deri në vendimin e saj nuk duhet të krijohen fakte të reja që mund ta thellojnë edhe më tej krizën kushtetuese”, tha Fetahu.

Në kërkesën drejtuar Kushtetueses kontestohet vendimi i 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e kryetarit të



Kuvendit, vendimi procedural i 11 shtatorit për mënyrën e votimit të nënkryetarëve, si dhe konstatimi i 13 shtatorit për konstituimin e Legjislaturës XI të Kuvendit të

Republikës së Kosovës.

PDK-ja kërkon që Gjykata Kushtetuese t'i vlerësojë këto vendime dhe procedura dhe t'i përcaktojë qartë pasojat juridike të shkeljeve eventuale

kushtetuese.

Të martën Partia Demokratike e Kosovës do ta dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese edhe lëndën që lidhet me formimin e qeverisë.

KURTI NË MBLEDHJEN E PARË TË QEVERISË BËN THIRRJE PËR BASHKËPUNIM PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të hënën mbledhjen e parë të qeverisë së re. Ai tha se një ditë më parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës u votua qeveria e re, Kurti 4 ndërkaq, sipas tij, sot zyrtarisht është dita e parë e punës nën qeverisjen e re të dalë nga procesi zgjedhor i 7 qershorit 2026, ndonëse realisht është veçse vazhdim i punës dhe i mandatit të ndërprerë pa nevojë e në dëm të vendit.

Kurti u ka shprehur mirënjohje qytetarëve për besimin e dhënë, deputetëve të Kuvendit për votimin. Ai ka thënë se përpara kanë shumë punë e projekte, sfida dhe probleme dhe vetëm bashkërisht do t'i dalin mbanë. “Qeverisja jonë e përbashkët është punë për qytetarin dhe mbrojtje për shtetin. Qeveria jonë është shërbim për publikun, jo privilegj për pakicën. Investimet tona do ta lartësojnë Republikën me qytetarë të sigurt dhe do të zhvillojnë



shoqërinë me familje të begatë. Të nderuar qytetarë, pas zgjedhjeve të rregullta të 9 shkurtit 2025, pas një mandati të plotë qeverisës katërvjeçar, kemi pasur dy palë zgjedhje të paarsyeshme, të kushtueshme dhe që nuk sollën rezultat tjetër. Dhjetë muaj bllokadë e barrikadim për të shkuar në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Qytetarët folën qartë para vitit të ri 2026. Por, barrikadim sërish për të shkuar përsëri në zgjedhje në 7 qershor 2026. Edhe njëherë qytetarët folën qartë. Në vitin 2025 shkua në zgjedhje për shkak të barrikadimit për Kuvend e

Qeveri, ndërkaq sivjet, më 2026, për shkak të barrikadimit për shkak të presidentit”, ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se tani janë me Kuvend të konstituuar e qeveri të zgjedhur, ndërkaq përpara kanë çështjen e presidentit dhe një marrëveshje politike mes subjekteve Lëvizja Vetëvendosje! dhe Lidhja Demokratike e Kosovës për kandidatin për president. “Para nesh është sfida me qëndrimin e shprehur nga disa deputetë nga radhët e LDK-së, të cilët nuk duan ta zbatojnë marrëveshjen e arritur me mund e përkushtim, pas një

procesi negociatash jo të lehta, të autorizuar nga kryesitë përkatëse të partive tona. Jemi kaq afër zgjidhjes së presidentit, sa që do të ishte e pafalshme të shkojmë sërish në zgjedhje për të ardhur përsëri në të njëjtën pikë. Andaj, si kryeministër i Republikës së Kosovës, por edhe si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje!, subjektit politik më të madh në vend e në Kuvend, ju bëj thirrje liderëve politikë, kolegëve të mi, deputetëve, le ta zgjidhim çështjen e presidentit, t'i japim vendit tonë institucione në përputhje me vullnetin qytetar dhe le të ecim përpara së bashku, ashtu siç i takon Republikës sonë e siç presin qytetarët tanë”, ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se është i bindur që edhe një proces i panevojshëm zgjedhor jo vetëm që nuk do të sillte diçka të re sa i përket mozaikut politik në vend, por përfundimisht do të ishte papërgjegjësi ndaj interesit publik dhe pamaturi e madhe politike. “Se gjetja e një kompromisi politik është e mundur dhe sjell rezultat, është dëshmi vetë konstituimi i

Kuvendit. Ne dje pranua plotësisht kandidaturat për nënkryetarë të Kuvendit nga PDK dhe LDK, përkundër vërejtjeve që kishim, dhe sot jemi me qeveri të re përveçse Kuvend të konstituuar. Një diskutim politik mes nesh, i hapur dhe i sinqertë, jam i bindur që do t'i sjellë vendit president të ri”, ka thënë Kurti. Kryeministri Kurti ka folur edhe për vendimin e Speciales për krerët e UÇK-së që do të jepet të mërkurën. “Pasnesër, pas dy ditësh, Kosova, ne të gjithë, presim vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli. Për ne është gjithçka e qartë, populli i Kosovës, rezistenca dhe lufta jonë ka qenë e drejtë, çlirimtare dhe kundrejt një pushtuesi, i cili kreu krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Besojmë e urojmë që edhe verdikti i së mërkurës të jetë në përputhje me këtë të drejtë dhe drejtuesit e UÇK-së të kthehen të lirë në vendin e tyre e pranë familjeve”, ka thënë Kurti.



“LIRIA KA EMËR” KA HAPUR KONFERENCËN KOMBËTARE “LUFTA PËR UÇK-NË”: PO NISIM NJË DIALOG TË BRENDSHËM PËR VLERAT E VËRTETA TË LUFTËS ÇLIRIMTARE

LUFTA E UÇK-së ËSHTË E VETMJA LUFTË ÇLIRIMTARE E CERTIFIKUAR NGA NATO-ja

Në prag të shpalljes së verdiktit final nga Dhomat e Specializuara në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, po mbahet konferenca kombëtare “Lufta për UÇK-në”, e organizuar nga platforma qytetare “Liria ka emër”. Në panelin e parë, Enver Hasani, Ylber Hysa dhe Enver Hoxhaj kanë shtjelluar temën “Konteksti i ri i krijuar nga Dhomat e Specializuara”. Ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj, ka theksuar se lufta e popullit tonë për liri përfundoi më 12 qershor 1999, ndërsa lufta diplomatike u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë më 2008. “Lufta e UÇK-së është e vetmja luftë çlirimtare e certifikuar nga NATO-ja. Dhe e vetmja drejtësi e pranuar është lirimi i plotë i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimi i tyre në Kosovë!”, ka thënë ai

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 14 shtator - Në prag të shpalljes së verdiktit final nga Dhomat e Specializuara në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, në Prishtinë është mbajtur konferenca kombëtare “Lufta për UÇK-në”, e organizuar nga platforma qytetare “Liria ka emër”. Hapja e konferencës është bërë nga përfaqësuesja e kësaj platforme, Eliza Hoxha, e cila tha se për gjashtë vjet ky proces ka qenë pjesë e pandashme e vëmendjes publike në Kosovë. “Kjo konferencë vjen si moment

për ta nisur një dialog të brendshëm për vlerat tona të vërteta, për historinë tonë, për pikat tona të përbashkëta edhe nëse nuk pajtohem, por ato duhet të jenë aty për t’i vlerësuar dhe adresuar”, tha ajo. Konferenca përmes tri paneleve të diskutimit synon ta rikthejë vëmendjen te narrativa që procesi gjyqësor në Hagë ka pasur për historinë e vendit, kujtesën kolektive të popullit të Kosovës dhe për luftën e UÇK-së. Në panelin e parë, Enver Hasani, Ylber Hysa dhe Enver Hoxhaj kanë shtjelluar temën “Konteksti i ri i krijuar nga Dhomat e Specializuara”. Panelistët theksuan rëndësinë e

ballafaqimit me historinë përmes argumenteve juridike, politike dhe historike, duke ngritur njëkohësisht çështjen e përgjegjësisë individuale për krimet e mundshme dhe dallimit të saj nga vlerësimi i luftës çlirimtare si proces historik. Në diskutim u trajtuan edhe dimensionet ndërkombëtare dhe gjeopolitike të procesit në Hagë, roli i NATO-s në luftën e Kosovës dhe përpjekjet për t’i sfiduar narrativat që, sipas panelistëve, synojnë ta cenojnë legjitimitetin e luftës dhe të shtetësisë së Kosovës. Deputeti i PDK-së, ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj, në konferencën kombëtare “Lufta

për UÇK-në”, ka theksuar se lufta e popullit tonë për liri përfundoi më 12 qershor 1999, ndërsa lufta diplomatike u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë më 2008. “Lufta speciale kundër Kosovës duhet të marrë fund më 16 shtator. Lufta e UÇK-së është e vetmja luftë çlirimtare e certifikuar nga NATO-ja. Dhe e vetmja drejtësi e pranuar është lirimi i plotë i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimi i tyre në Kosovë!”, ka thënë ai.

Hoxhaj ka kritikuar gjithashtu pretendimet e Prokurorisë në fjalën përmbyllëse, duke thënë se ato, sipas tij, tentojnë të kriminalizojnë jo vetëm idenë e çlirimit, por edhe procesin e pavarësimi të Kosovës. “Kur dëgjon pretendimet e prokurores në fjalën përmbyllëse, të cilat bëjnë përpjekje që ta kriminalizojnë edhe idenë e çlirimit përmes teorisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por edhe vetë idenë e pavarësimi të vendit, duhet të kujtojmë se si çlirimi, ashtu edhe pavarësimi i vendit, përtej çdo vullneti politik, kanë qenë edhe projekt kombëtar”, ka thënë

Hoxhaj. Sipas tij, e drejta dhe e pranueshme është lirimi i plotë i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimi i tyre në shtëpi. “Atëherë, kur diçka e tillë është e padrejtë, për ne është e papranueshme. Ajo çfarë është e drejtë dhe e pranueshme është lirimi i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së në mënyrë të plotë dhe kthimi i tyre në shtëpi. Ajo që duhet të mendojmë është se cila mund të jetë faza e re e luftës speciale kundër Kosovës pas 16 shtatorit. Mendoj se, pas shpalljes së pavarësisë dhe mbrojtjes së Kosovës, ne kemi krijuar kapacitetet tona për t’u ballafaquar me këtë luftë speciale, me këtë luftë hibride kundër Kosovës. Mendoj se më 16 shtator kjo luftë përfundon, nëse merret vendimi për lirim të plotë të tyre”, ka shtuar Hoxhaj. Ndërkaq ish-ambasadori Ylber Hysa ka deklaruar se, nëse një pretendim i tillë makabër ka qenë i mjaftueshëm për ta tronditur botën, atëherë shtrohet pyetja pse dhuna sistematike dhe masive gjatë luftërave në ish-Jugosllavi nuk e ka tronditur botën në të njëjtën masë. “Ajo që shtrohet është: nëse një

HASANI: KUVENDI ËSHTË KONSTITUUAR NË SHKELJE TË KUSHTETUTËS

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Konstituimi i Kuvendit të Kosovës është bërë në shkelje të Kushtetutës dhe një vendim që do ta konstatonte këtë, do të mund ta vinte në pikëpyetje edhe zgjedhjen e qeverisë Kurti 4, thotë Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Hasani thotë se pret që Gjykata Kushtetuese të vendosë masë të përkohshme dhe ta pezullojë veprimtarinë e Kuvendit deri në shqyrtimin përfundimtar të rastit. Në një skenar të tillë, sipas tij, Kuvendi nuk do të mund të mbledhë, ndërsa fati i qeverisë së sapozgjedhur do të mbetej pezull. Komentet vijnë në ditën kur Partia Demokratike e Kosovës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e vendit të vendosë masë të përkohshme lidhur me konstituimin e Kuvendit më 13 shtator. Ish-kreu i Kushtetueses paralajmëron se kriza mund ta prekë edhe procesin e zgjedhjes së presidentit, të cilin, në rrethanat aktuale, e konsideron “komprometues” për vendin. “Konstituimi i Kuvendit të dielën nuk ka ndjekur asnjë rrugë kushtetuese të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në veçanti me nenin 67 të saj, me nenin 12 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese që i kanë interpretuar këto dispozita në të kaluarën”, ka thënë ai. Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se Kuvendi “nuk mund të mbetet peng i askujt, i asnjë subjekti politik” dhe u thirr në një aktgjykim të mëhershëm të Kushtetueses. Cili është koment i juaj? “Konstatimi i zonjës Haxhiu është fund e krye arbitrar për shkak se ajo nuk mund të



provojë se nga partia e dytë më e madhe politike ka pasur sabotim dhe heqje dorë nga ushtrimi i një të drejte kushtetuese. Se kur mund të konsiderohet se ka ndodhur një sabotim dhe, për pasojë, mosushtrim i së drejtës kushtetuese për ta propozuar kandidatin për nënkryetar, është përcaktuar në aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb. Arsyetimi për tërheqjen e kandidatit të partisë së dytë më të madhe për nënkryetar të Kuvendit duhet të vlerësohet në kontekstin e gjendjes së stërzgatur jokushtetuese, të

krijuar nga zonja Haxhiu dhe, para saj, nga zoti [kryesuesi i seancës konstituive Avni] Dehari, gjatë tërë procesit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës”. I pyetur se PDK-ja e ka dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese dhe ka kërkuar edhe masë të përkohshme. Çfarë mund të vendosë Gjykata në këtë fazë?, Hasani ka thënë se marrë parasysh faktin se në aktgjykimin e saj lidhur me kandidatin serb për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar çështjet relevante, përfshirë edhe situatën kur një forcë politike nuk e ushtron të drejtën e saj kushtetuese në procesin e

konstituimit të Kuvendit të Kosovës, është e pritshme që Gjykata të vendosë masë të përkohshme dhe, më pas, të vendosë për meritat e rastit. “Nuk do të ishte profesionale që Gjykata, tani kur çështja është e qartë, të lejonte funksionimin e Kuvendit të Kosovës, i cili, sipas këtyre parametrave kushtetues, është konstituuar në shkelje të Kushtetutës”, ka thënë Hasani, duke shtuar se Gjykata e ka bërë këtë edhe herën e kaluar, kur Kuvendi i Kosovës, në mënyrë jokushtetuese, e konsideroi veten të konstituuar dhe vendi më pas shkoi në zgjedhje. “Tani që situata është sqaruar përmes aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit nuk do

të duhej të lejonte që gjendja jokushtetuese të vazhdonte më tej. Kjo është veçanërisht e rëndësishme edhe për faktin se, sipas të gjithë parametrave kushtetues, situata aktuale ka dalë jashtë binarëve normalë kushtetues dhe mund të ndikojë edhe në një votim eventual për presidentin e Republikës. Është e sigurt se gjendja jokushtetuese e krijuar në Kuvend prodhon pasoja nga dita e dhënies së betimit të deputetëve e deri te vendimi për zgjedhjen e qeverisë Kurti 4”, ka thënë Hasani. Në pyetjen se nëse Gjykata e shpall jokushtetues konstituimin e Kuvendit, çfarë pasojash do të kishin vendimet e marra ndërkohë, përfshirë zgjedhja e Qeverisë së re të Kosovës? Enver Hasani ka theksuar se: “Sipas rregullit, nëse Gjykata Kushtetuese shpall jokushtetues konstituimin e Kuvendit të Kosovës - diçka që vështirë se mund të mos ndodhë, marrë parasysh atë që thashë më sipër dhe standardet kushtetuese që vetë Gjykata i ka përcaktuar - atëherë ajo duhet të konstatojë edhe jokushtetutshmërinë e vendimit për zgjedhjen e Qeverisë Kurti 4 dhe ta rikthejë gjendjen në afatet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Kjo është kështu për dy arsye. E para, moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit prej 30 ditësh nuk prodhon si pasojë juridike automatike shkuarjen e vendit në zgjedhje. E dyta, Qeveria Kurti 4 është zgjedhur në votimin e parë, kështu që jokushtetutshmëria eventuale e këtij votimi nuk prek rundin e dytë të procedurës për zgjedhjen e Qeverisë, pas dështimit të të cilit vendi shkon në zgjedhje në përputhje me procedurën kushtetuese të nenit 95 dhe aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese që ka rrëzuar Qeverinë Hoti”.

pretendim i tillë makabër është dashur ta shokojë botën, pse atëherë nuk e ka shokuar botën dhunimi industrial në luftërat e ish-Jugosllavisë? Ose pse i ashtuquajtur i ‘safari mbi njerëz’ në Sarajevë nuk ka qenë kaq makabër sa të organizohej një gjyq ndërkombëtar?”, ka thënë Hysa. Sipas tij, mënyra se si është zhvilluar procesi gjyqësor në Hagë ka dëmtuar besueshmërinë e tij dhe, pavarësisht prej vendimit që do të merret më 16 shtator, Kosova duhet të ketë një qasje të qartë në mbrojtje të vlerave të luftës çlirimtare. “Dhe këtu është cinizmi i gjithë këtij gjyqi. Sa më përket mua, pa marrë parasysh cili do të jetë vendimi më 16 shtator, fakti që ky gjyq e ka zhvlerësuar veten, jo vetëm se është anakronik, por se i ka shkelur edhe rregullat profesionale, për të cilat zoti Hasani do të mund të fliste më

shumë sot. Besoj se kjo duhet të na japë një ndërgjegjësime për t’i mbrojtur vlerat e luftës çlirimtare mbi të cilat është ndërtuar ky shtet”, ka deklaruar Hysa. Ai ka bërë thirrje për mobilizim në mbrojtje të këtyre vlerave, duke theksuar se mbështetja nuk duhet të kufizohet vetëm te katër ish-krerët e UÇK-së që po gjykohen në Hagë. “Unë jam i prirë që, në kuadër të kësaj, të shoh edhe një përpjekje tonën për mobilizim, për ta mbrojtur veten. Ne nuk i mbrojmë vetëm katër liderët e UÇK-së. Këtu nuk besoj se ka dallim politik e ideologjik. Këtu ne mbrojmë vlerat tona dhe kushdo që mendon ndryshe, ka shikime shumë afatshkurtra. Dua të them edhe një herë: në vitin 1999 kemi qenë aleatë me NATO-n dhe edhe më 16 shtator do të duhej të ishim aleatë të këtyre vlerave”, ka shtuar Hysa.

Profesori Enver Hasani ka thënë se, pas publikimit të raportit të Dick Martyt, Kosova ka qenë në defensivë, ndërsa me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, sipas tij, është dëshmuar se raporti dhe procesi që pasoi kanë qenë pjesë e një strategjie për arritjen e një qëllimi të caktuar. “Siç e dimë, nga momenti kur është bërë publik raporti i Dick Martyt ne kemi qenë në defensivë. Ka qenë një çështje dhe një proces mjaft i komplikuar. Të gjithë njerëzit kanë besuar, sepse ka qenë fjala për një raport. Por, me mënyrën se si janë zhvilluar ngjarjet, ne gradualisht kemi filluar të shohim se ajo ka qenë një strategji e dizajnuesve të kësaj gjykate dhe se është përdorur si mjet për të arritur një qëllim të caktuar”, ka thënë Hasani. Hasani ka folur edhe për dimensionin gjeopolitik të

themelimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, duke pretenduar se Rusia ka pasur rol instrumental në bashkëpunim me Serbinë në këtë proces. “Duhet të thuhet se, përveç aspektit teknik që është prodhuar, rusët kanë qenë instrumentalë me serbët në çdo detaj të tij. Është e kuptueshme se ne jemi të vetëdijshëm që Serbia asnjëherë nuk mund ta pranojë realitetin që është krijuar në Kosovë dhe ajo e ka përdorur dhe do ta përdorë këtë proces për delegitimimin e shtetësisë së Kosovës”, ka deklaruar ai. Sipas Hasanit, dimensionin gjeopolitik, si atëherë, ashtu edhe sot, ka qenë vendimtar në themelimin e Dhomave të Specializuara. “Dimensioni gjeopolitik atëherë dhe sot ka qenë vendimtar në themelimin e saj, pra të Dhomave të Specializuara në Hagë. Është e qartë se ajo ka

qenë pjesë e procesit të marrëveshjes me rusët, për t’i qetësuar gjakrat, duke pretenduar se Serbia po thotë se shqiptarët kanë kryer vrasje dhe se kjo duhet të hetohet”, ka thënë Hasani. Ai ka shtuar se, nëse Dhomat e Specializuara nuk do të ishin themeluar nga Kuvendi i Kosovës atëherë, sipas tij, ato do të ishin themeluar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. “Edhe unë besoj se në ato kontekste të atëhershme, po të mos ishte formuar nga Kuvendi i Kosovës, kam qenë atëherë dhe sot jam krejtësisht i sigurt se do të ishte formuar nga OKB-ja, pa asnjë diskutim, dhe gjërat do të kishin shkuar edhe shumë më keq për Kosovën për shkak se kontrolli i aleatëve ndaj një procesi të drejtë dhe të paanshëm do të kishte qenë marginal”, ka përfunduar Hasani.

SI PO PËRDORET IA-ja PËR SIGURINË NË SHKOLLAT E SHQIPËRISË

TIRANË, 14 SHTATOR - Në njëzet shkolla në Shqipëri kamerat nuk regjistrojnë më vetëm atë që ndodh. Një sistem i inteligjencës artificiale (IA) analizon pamjet dhe mund të sinjalizojë automatikisht te strukturat përgjegjëse sjellje të programuara paraprakisht si të dyshimta ose potencialisht të rrezikshme. Autoritetet e paraqesin teknologjinë si një mjet për të parandaluar incidente dhe për ta rritur sigurinë e nxënësve. Por, hyrja e inteligjencës artificiale në mjediset shkollore ngre edhe një pyetje: deri ku mund të shkojë mbikëqyrja në emër të sigurisë së fëmijëve? Prindër dhe ekspertë të teknologjisë ngrenë dilema për të dhënat që sistemi mund të mbledhë, mënyrën se si përpunohen dhe ruhen ato, kush mund të ketë qasje në to dhe nëse ekzistojnë mekanizma të mjaftueshëm të pavarur për ta mbikëqyrrur teknologjinë. Debat i zhvillohet ndërsa Shqipëria ende nuk ka miratuar Ligjin për Inteligjencën Artificiale dhe institucionet nuk kanë sqaruar nëse, para vendosjes së sistemit, është kryer ndonjë vlerësim specifik i ndikimit të tij në mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga kamerat tek inteligjenca artificiale

Njëzet shkollat e përfshira në projekt kishin kamera edhe më herët. Ajo që ka ndryshuar, është mënyra se si analizohen pamjet. Ministria e Brendshme e Shqipërisë i tha Radios Evropa e Lirë se funksionalitetet inteligjente nuk kryhen nga vetë kamerat, por nga platforma e analizës së videos. “Sistemi përdor teknologji të inteligjencës artificiale për analizimin e pamjeve, për identifikimin e ngjarjeve ose sjelljeve të programuara paraprakisht si potencialisht të rrezikshme ose të dyshimta, duke gjeneruar sinjalizime (alerts) për verifikim nga strukturat përgjegjëse”, thuhet në përgjigje. Sipas saj, çdo funksionalitet që përfshin përpunimin e të dhënave personale, përfshirë analizat e fytyrave, zbatohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe standardet e privatësisë. Projekti, sipas Ministrisë, nuk parashikon përpunimin e regjistrimeve audio. Shkollat janë përzgjedhur duke marrë parasysh nevojën për forcimin e masave parandaluese të sigurisë, dendësinë e popullsisë në zonë dhe numrin e nxënësve. Pjesa më e madhe e njëzet institucioneve ndodhen në Tiranë dhe në bashkinë Kamëz. Vendosja e sistemit vjen në një periudhë kur siguria në shkolla është kthyer në një çështje të ndjeshme publike në Shqipëri. Vrasja me thikë e nxënësit Martin Cani pranë shkollës “Fan Noli” në Tiranë, më 18 nëntor 2024, ishte një nga ngjarjet që nxiti debat të

gjerë për masat e sigurisë. Kryeministri Edi Rama e paraqiti teknologjinë si pjesë të përgjigjes së shtetit ndaj këtij problemi. Por, pikërisht mënyra se si kjo teknologji funksionon, ngre tani shqetësime të reja.

Siguri apo mbikëqyrje?

Përtej aftësisë së sistemit për të sinjalizuar incidente, prindër dhe ekspertë kërkojnë të dinë se çfarë tjetër mund të prodhojë analiza e vazhdueshme e pamjeve të nxënësve. Ermelinda Hoxhaj, nënë e dy fëmijëve dhe aktiviste e grupimit “Prindër për arsim cilësor”, thotë se prindërit nuk janë konsultuar për projektin. “Me këtë projekt besoj se tejkalohet çështja e sigurisë. Këtu nis një rrezik i madh i shkeljes së privatësisë së fëmijëve dhe adoleshentëve”, thotë Hoxhaj për Radion Evropa e Lirë. Ajo paralajmëron se monitorimi i vazhdueshëm mund të ndikojë edhe në gjendjen psikologjike të nxënësve. Ministria e Brendshme i tha REL-it se prindërit janë konsultuar për projektin, ndërsa Ministria e Arsimit nuk iu përgjigj pyetjeve nëse janë zhvilluar konsultime të tilla dhe nëse mund të ofrojë dokumentacion që i dëshmon ato.

Sipas saj, kriteret e përzgjedhjes së shkollave, analizat e riskut, specifikimet teknike dhe dokumentacioni përkatës administrohen nga Ministria e Brendshme. Orkidea Xhaferraj, eksperte për politikën digjitale dhe inovacionin, thotë se mungesa e informacionit publik e bën të vështirë të kuptohet se deri ku shkojnë aftësitë e sistemit. Sipas saj, nuk ka informacion të mjaftueshëm për teknologjinë e përdorur, llojin e të dhënave që mbledhen, kohën e ruajtjes së tyre dhe mundësinë që sistemi të krijojë metadata apo profile të sjelljes. “Nuk mjaftojnë deklaratat publike që e gjitha bëhet për të rritur sigurinë në shkolla. Çështja është se çfarë analizon ky sistem, si mund të përdoren apo të keqpërdoren këto të dhëna në të ardhmen. Këto janë sisteme të riskut të lartë, sisteme të inteligjencës artificiale, të cilat bëjnë ‘facial recognition’ [njohje të fytyrës] dhe ‘biometric data analysis’ [analizë të të dhënave biometrike]. Ne nuk e dimë nëse bëjnë edhe ‘emotion analysis’ [analizë emocionale]”, thotë Xhaferraj për Radion Evropa e Lirë.

Për Luiza Myrtaj Nezhën, mësuese në shkollën nëntëvjeçare “Skënder Luarasi” në Tiranë, teknologjia mund të jetë pjesë e zgjidhjes, por jo zgjidhja e vetme. “Kamerat janë të dobishme për rritjen e sigurisë dhe sqarimin e ngjarjeve kur ndodhin incidente, por ato nuk i mësojnë nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin, nuk ulin ankthin, nuk zhvillojnë aftësi emocionale dhe nuk zgjidhin konfliktet në rrënjë”, thotë ajo. Sipas saj,



siguria në shkolla kërkon edhe më shumë psikologë, programe sociale dhe aktivitete që zhvillojnë komunikimin, empatinë dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve.

Një muaj pamjet, një vit sinjalizimet

Një nga pyetjet kryesore është se çfarë ndodh me të dhënat pasi sistemi i ka mbledhur dhe analizuar ato. Ministria e Brendshme tha për REL-in se pamjet e kamerave në shkolla do të ruhen në infrastrukturën lokale të institucioneve arsimore për një muaj. Por, jo çdo e dhënë zhduket pas një muaji. Sinjalizimet e gjeneruara automatikisht nga sistemi dhe metadata-t përkatëse do të ruhen për një vit në sistemin qendror të administruar nga Policia e Shtetit. “Të gjitha të dhënat ruhen dhe përpunohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk transferohen në serverë apo infrastruktura jashtë juridiksionit shqiptar”, tha Ministria. Sipas saj, pas përfundimit të afatit përkatës, të dhënat fshihen ose mbishkruhen automatikisht. Por, Xhaferraj thotë se mbetet e paqartë nëse fshirja e pamjeve nënkupton edhe fshirjen e çdo të dhëne tjetër që sistemi mund të ketë prodhuar nga analiza e tyre. “Vendndodhja fizike e një serveri brenda Shqipërisë nuk do të thotë që nuk mund të ketë ‘akses remote’. Ne nuk dimë kush janë zhvilluesit e softuerit, si është bërë implementimi, kush e kontrollon, kush i ka kodet e tij... Këtyre pyetjeve nuk u jepet përgjigje”, thotë ajo.

Pyetje pa përgjigje për vlerësimin e rrezikut

Pikëpyetjet për privatësinë bëhen edhe më të rëndësishme për shkak se sistemi përpunon pamje të fëmijëve dhe përdor teknologji të reja. Ligji shqiptar parashikon një mekanizëm pikërisht për raste kur përpunimi i të dhënave mund të krijojë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e individëve: Vlerësimin e Ndikimit në

Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ose DPIA. Komisionari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale thotë për Radion Evropa e Lirë se përgjegjësia për kryerjen e këtij vlerësimi i takon kontrolluesit të të dhënave - në këtë rast, Ministrisë së Brendshme. Sipas Komisionarit, kur përdorimi i teknologjive të reja mund të krijojë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë themelore, kontrolluesi duhet ta kryejë vlerësimin përpara se të nisë përpunimi i të dhënave. Megjithatë, pyetjes së REL-it nëse një DPIA është kryer për projektin në shkolla, Ministria e Brendshme nuk i dha një përgjigje të drejtpërdrejtë. Ajo tha vetëm se projekti “po zhvillohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike dhe sigurinë e informacionit”. Komisionari sqaroi se ligji nuk e detyron kontrolluesin që ta njoftojë apo konsultojë paraprakisht Zyrën e Komisionarit për një projekt të tillë. Ministria e Arsimit tha se mbështet përdorimin e teknologjisë për rritjen e sigurisë në institucionet arsimore, por se çdo masë duhet të zbatohet duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat themelore të nxënësve.

Teknologjia ec përpara ligjit

Sistemi po vendoset në shkolla në një moment kur Shqipëria ende nuk ka një ligj të posaçëm për inteligjencën artificiale. Projektligji për Inteligjencën Artificiale ka përfunduar fazën e konsultimit publik. Dhoma Amerikane e Tregtisë e ka vlerësuar atë si hap të nevojshëm drejt harmonizimit me Aktin e Inteligjencës Artificiale të Bashkimit Evropian, por ka kërkuar ndryshime. Një ndër propozimet është që funksioni rregullator dhe mbikëqyrës t'i besohet një autoriteti të pavarur, veçanërisht Komisionarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Xhaferraj thotë se një mbikëqyrje

e tillë është veçanërisht e rëndësishme për sistemet me rrezik të lartë. “Institucioni, i cili e implementon, nuk mund të jetë edhe ai që kryen mbikëqyrjen e këtij lloj sistemi dhe reziqet që sjell”, thotë ajo. Sipas saj, një institucion i pavarur duhet të jetë në gjendje ta auditojë sistemin dhe të verifikojë nëse të dhënat e mbledhura përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë marrë.

Nga 20 shkolla në një sistem kombëtar

Kamerat në shkolla janë vetëm një pjesë e një projekti shumë më të madh. “Smart City” është projekt kombëtar i sigurisë dhe monitorimit, i administruar nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, që parashikon përdorimin e kamerave inteligjente, inteligjencës artificiale, radarëve dhe sensorëve. Ai pritet të shtrihet në 873 lokacione në Shqipëri, në 24 qytete, 28 pika të kalimit kufitar dhe 12 drejtoritë vendore të Policisë. Përveç sistemit të analizës së pamjeve, projekti përfshin kamera trupore për policinë, sistemin automatik të njohjes së targave të automjeteve, radarë dhe sensorë zhurme. Por, përmasat e projektit nuk janë e vetmja çështje që ka shkakuar debat. Vlera e tij ishte përlllogaritur fillimisht në rreth 60 milionë dollarë. Më pas, projekti u lidh me një marrëveshje huaje prej 118.5 milionë dollarësh me Fondin për Zhvillim të Abu Dhabit. Diferenca ka ngritur pikëpyetje për koston, mënyrën e financimit dhe transparencën e projektit. Ministria e Brendshme i tha REL-it se kontrata me Fondin për Zhvillim të Abu Dhabit dhe dokumentacioni teknik përmbajnë elemente që lidhen me infrastrukturën kritike, sigurinë publike dhe funksionimin e sistemeve teknologjike. Sipas Ministrisë, marrëveshja përmban gjithashtu dispozita që lidhen me imunitetin e Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit nga censurimi dhe inspektimi i publikimeve.

Prishtina 2030: Kryeqyteti miraton lokacionet për projektet strategjike të Lojërave Mesdhetare

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kuvendi i Kryeqytetit ka votuar lokacionet për projektet strategjike që do të realizohen në kuadër të përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se 71 për qind e aktiviteteve të

Lojërave Mesdhetare të vitit 2030 do të zhvillohen në Prishtinë. Sipas Ramës, në kuadër të transformimit të kryeqytetit parashihen projekte të rëndësishme, përfshirë Fshatin Olimpik, Qendrën Multisportive, Vertical Gym, Unazën e Qytetit, rrjetin e parkingjeve

nëntokësore, Parkun Botanik dhe projektet në Gollak. Rama ka falënderuar për mbështetjen përfaqësuesin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, Patrick Gan, përfaqësuesin e KUSA-s, si dhe asamblistët që votuan për këto vendime. "Tash kemi më pak se katër vjet. Çdo ditë

ka rëndësi. Në 2030 organizojmë Lojërat. Për dekada pas tyre, Prishtina jeton me atë që ndërtojmë sot", ka deklaruar Rama. Ai ka theksuar se projektet e planifikuara nuk do t'i shërbejnë vetëm organizimit të Lojërave Mesdhetare, por do të kenë ndikim afatgjatë në



zhvillimin dhe transformimin urban të Prishtinës.

RUTTE: KFOR-i ËSHTË ATY, PAVARËSISHT Ç'MUND TË NDODHË KËTË JAVË NË KOSOVË

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se përkushtimi i Aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë do të mbetet i pandryshuar pavarësisht prej zhvillimeve të mundshme lidhur me aktgjykimin ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin më 16 shtator aktgjykimin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, në rastin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katërt janë deklaruar të pafajshëm për dhjetë pikat e aktakuzës. Sipas Ruttes, KFOR-i është aty, në Kosovë, për të siguruar që NATO-ja të kontribuojë në

stabilitet dhe paqe, ndërsa misioni paqeruajtës i Aleancës, sipas tij, ka kontribuar për më shumë se dy dekada në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë. "Kjo vlen edhe sot, pavarësisht se çfarë lajmesh mund të vijin këtë javë ose në periudhën e ardhshme, por edhe sa i përket zotimit afatgjatë për paqe dhe siguri në Kosovë", tha Rutte në një konferencë për media në selinë e NATO-s në Bruksel më 14 shtator, kur u pyet nëse është i shqetësuar për trazira të dhunshme të mundshme në Kosovë dhe rajon si rezultat i vendimit pavarësisht se si do të jetë ai. Shefi i NATO-s tha se aleanca ushtarake perëndimore do të vazhdojë ta vlerësojë përbërjen dhe vendosjen e trupave të KFOR-it, për të siguruar që misioni të përshtatet në



mënyrë adekuate me situatën e sigurisë në Kosovë. Ai theksoi se zhvillimet në Kosovë ndikojnë edhe në rajonin më të gjerë. Deklaratat e shefit të NATO-s vijnë disa orë pasi Ambasada Amerikane në Prishtinë u bëri thirrje shtetasve amerikanë që t'i shmangin lëvizjet në afërsi të vendeve, ku siç tha, janë

paralajmëruar protesta më 16 shtator. Ambasada tha se disa organizata po planifikojnë demonstrata të mëdha më 16 shtator në qendër të Prishtinës dhe qytete të tjera të mëdha të Kosovës. "Këto demonstrata mund të shkaktojnë grumbullime të mëdha njerëzish, mbyllje të rrugëve dhe ndërprerje në trafik", tha Ambasada duke i udhëzuar shtetasit amerikanë që të kufizojnë lëvizjet në këto zona. Shpallja e aktgjykimit në Hagë vjen katër ditë pasi në Prishtinë mijëra persona morën pjesë në "Marshin për Liri", ku pjesëmarrësit kërkuar që vendimi të jetë i drejtë dhe paanshëm. Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë pretendon se katër ish-eprorët e UÇK-së mbajnë përgjegjësi

penale për krime të kryera në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë gjatë periudhës së luftës. Aktakuza ndaj tyre përfshin gjashtë pika për krime kundër njerëzimit dhe katër për krime lufte dhe Prokuroria ka kërkuar nga 45 vjet burgim për secilin të akuzuar. Të katër ish-krerët e UÇK-së u arrestuan në nëntor 2020 dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjykimi nisi më 3 prill 2023. Aktgjykimi i 16 shtatorit pritet të jetë një prej vendimeve më të rëndësishme të Dhomave të Specializuara, të krijuara në vitin 2015 për gjykimin e rasteve që lidhen me pretendime për krime të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së gjatë dhe pas luftës së viteve 1998-1999.



KAPITENI I FSK-së U VLERËSUA ME TITULLIN "DISTINGUISHED HONOR GRADUATE" NË SHBA

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kapiteni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, E. V., ka përfunduar me sukses Kursin Kualifikues të Forcave Speciale të Ushtrisë Amerikane - U.S. Army Special Forces Qualification Course (SFQC), në U.S. Army John F. Kennedy Special Warfare Center and School, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pas më shumë se tetë muajsh trajnim intensiv, nga janari deri në shtator 2026, kapiteni përfundoi programin e kualifikimit për Green Berets, i cili përfshin përgatitje të

avancuar në taktika të njësive të vogla, planifikim dhe udhëheqje të operacioneve speciale, kualifikimin 18A Special Forces Detachment Officer, si dhe ushtrimin përfundimtar Robin Sage. Në përfundim të kursit, kapiteni u vlerësua me titullin "Distinguished Honor Graduate", duke dëshmuar nivel të lartë të performancës profesionale, lidershipit dhe përkushtimit gjatë gjithë procesit të kualifikimit. Kjo arritje përfaqëson një sukses të rëndësishëm profesional dhe njëkohësisht dëshmon

përkushtimin e vazhdueshëm të FSK-së për ngritjen e kapaciteteve në fushën e operacioneve speciale, zhvillimin e kuadrove profesionale dhe avancimin e ndërveprueshmërisë me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe partnerët strategjikë. Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdojnë të investojnë në zhvillimin profesional të pjesëtarëve përmes edukimit dhe trajnimit në institucionet prestigjioze ushtarake të vendeve partnere.

Gjyqtari Kreshnik Kaçi pranon detyrën e kryetarit të Gjykatës Administrative

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Kryetari i sapozgjedhur i Gjykatës Administrative të Kosovës, gjyqtari Kreshnik Kaçi, edhe zyrtarisht pranoi detyrën të cilën ia dorëzoi ushtruesi i deritanishëm i detyrës së kryetarit, gjyqtari Rexhep Gashi. Me këtë rast, kryetari Kaçi, i

cili mori përgjegjësinë për drejtimin e Gjykatës Administrative, u zotua për avancimin e punës së Gjykatës për përmbushjen e misionit të saj, me fokus forcimin e mëtejshëm të efikasitetit, profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

Gjatë ceremonisë së pranim-dorëzimit, kryetari Kaçi i shprehu mirënjohje gjyqtarit Gashi për kontributin e dhënë gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës së kryetarit, veçmas për angazhimin e tij në fillimet e punës së Gjykatës Administrative. Nga ana e tij, ish-ushtuesi i

detyrës së kryetarit të Gjykatës Administrative, gjyqtari Rexhep Gashi, e uroi gjyqtarin Kaçi për emërimin në pozitën e kryetarit, duke i dëshiruar mbarësi dhe suksese në punë. Gjyqtari Kreshnik Kaçi është zgjedhur dhe emëruar kryetar i Gjykatës Administrative, më 10 shtator 2026, në mbledhjen e



372-të të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Transporti ajror dhe telefonja në rritje, bie numri i udhëtarëve në hekurudha gjatë korrikut

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e transportit dhe telekomunikimit për muajin korrik 2026. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna statistikore mujore për transportin ajror, hekurudhor dhe telekomunikimin. Transporti ajror: Në muajin korrik 2026 numri i fluturimeve

të realizuara ishte 3 254 ose 4,5 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Numri i udhëtarëve në total ishte 475 269 ose 3,8 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (korrik 2025). Transporti hekurudhor: Në muajin korrik 2026 numri i udhëtarëve në transportin hekurudhor ishte 7 126 ose (-5,9 %) më pak sesa në

periudhën e njëjtë të vitit 2025. Ndërsa mallra të transportuara përmes transportit hekurudhor nuk kishte në këtë muaj. Telefonja fikse: Në muajin korrik 2026 numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 70 104 me një rritje prej 3.2 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa trafiku i realizuar (në

minuta) ishte 2 318 571 me një rritje prej 9.7 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Telefonja mobile: Në muajin korrik 2026 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 679 450 ose 3.55 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa numri i përdoruesve



me kontratë (Postpaid) ishte 323 728 ose 1.37 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

BQK-ja FORCON RRJETIN E SIGURISË FINANCIARE TË KOSOVËS PËRMES QASJES NË MEKANIZMIN E AVANCUAR EUREP TË BQE-së

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka pranuar konfirmimin për përfshirjen e saj në mekanizmin e avancuar të Eurosistemit për transaksionet REPO me bankat qendrore - Eurosystem Repo Facility for Central Banks (EUREP), i themeluar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Ky zhvillim shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e mëtejshëm të kornizës së BQK-së për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe menaxhimin e likuiditetit në euro. Ai shton një shtresë të re qëndrueshmërie për sistemin financiar të Republikës së Kosovës. BQK-ja aktualisht ka qasje në një linjë REPO deri në 100

milionë euro, të vlefshme deri më 31 janar 2027. Përfshirja në kornizën e avancuar EUREP përfaqëson kalimin nga kjo marrëveshje e kufizuar në shumë dhe kohë drejt kornizës së përhershme të Eurosistemit për sigurimin e likuiditetit mbështetës në euro për bankat qendrore jashtë zonës së euros. Në kuadër të kornizës së avancuar EUREP, bankat qendrore të pranueshme mund të sigurojnë likuiditet në euro kundrejt kolateralit cilësor të denominuar në euro. Kapaciteti maksimal i një linje individuale në kuadër të kësaj kornize mund të arrijë deri në 50 miliardë euro, në varësi të kërkesave të zbatueshme dhe



aranzhimeve operacionale të Eurosistemit. Guvernatori Ahmet Ismaili e mirëpriti këtë zhvillim si një arritje të rëndësishme në

forcimin e mëtejshëm të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar të Kosovës. Guvernatori Ismaili gjithashtu theksoi se ky zhvillim pasqyron

avancimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit institucional të BQK-së me bankat qendrore evropiane dhe Eurosistemin. Shuma e disponueshme në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të përcaktohet në përputhje me nevojat e vlerësuara, kërkesat e zbatueshme dhe kolateralin e pranueshëm, brenda limit të përgjithshëm të përcaktuar nga BQE. Ky zhvillim plotëson reformat dhe masat e vazhdueshme të BQK-së për forcimin e stabilitetit financiar, mbikëqyrjes prudenciale, menaxhimit të rezervave dhe integritetit të Kosovës me infrastrukturën dhe mekanizmat financiarë evropianë.

IQMT SHTON ‘AKSIONIN’ NË TEKSTIL, NË FOKUS ÇMIMET, ULJET DHE ABUZIMET ME KONSUMATORËT

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Në kuadër të planit të punës, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT) ka shtuar inspektimet në dyqanet e tekstilit, me fokus në respektimin e rregullave që ndërlidhen me tregtinë, produktet dhe mbrojtjen e konsumatorit. Gjatë inspektimeve po kontrollohen dokumentacioni i biznesit, faturat dhe origjina e mallrave, çmimet, etiketimi i veshjeve, deklarimi i produkteve, promocionet dhe uljet, si dhe kushtet e shitjes dhe të kthimit të produkteve. Duke marrë parasysh se gjatë muajit shtator qytetarët shfaqin interesim të shtuar për blerjen e veshjeve për sezonin e vjeshtës, ndërsa shumica e bizneseve të tekstilit zhvillojnë aksione promovionale, IQMT e konsideron të domosdoshëm



shtimin e inspektimeve gjatë sezoneve të veçanta të vitit, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së konsumatorëve nga praktikat

e padrejta dhe abuzimet e mundshme. Fokus i veçantë gjatë këtyre inspektimeve po i kushtohet

verifikimit të çmimeve, përkatësisht nëse produktet kanë çmime të shënuara qartë dhe nëse çmimi i aplikuar në

arkë përputhet me çmimin e ekspozuar ose me çmimin e promovuar përmes aksioneve promovionale. Inspektimet lidhur me dokumentacionin e biznesit, faturat, deklaracionet dhe çmimet e produkteve të tekstilit do të përfshijnë edhe bizneset që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes online. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit çdo ditë pranon ankesa nga qytetarët të cilët raportojnë raste të mospërputhjes ndërmjet çmimit të shënuar dhe çmimit të llogaritur në arkë. Për këtë arsye çdo mangësi apo shkelje e konstatuar gjatë inspektimeve do të trajtohet në përputhje me masat ndëshkuese të përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Kusari: Mandat i ri, vazhdojmë punën për një ekonomi më të fortë

PRISHTINË, 14 SHTATOR - Ministri e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari, ka nisur javën e re me një takim me drejtorët e departamenteve dhe agjencive përgjegjëse pranë kësaj ministrie. Kusari ka thënë se me fillimin e mandatit të ri, puna do të

vazhdojë me energji të re dhe me të njëjtin përkushtim. “Javë e re, mandat i ri. E nisa javën me takimin e rregullt me drejtorët e departamenteve dhe agjencive përgjegjëse pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit”, ka shkruar Kusari. Ajo ka theksuar se synimi

mbetet forcimi i ekonomisë dhe krijimi i më shumë mundësive për qytetarët. “Me energji të re dhe të njëjtin përkushtim, vazhdojmë punën për një ekonomi më të fortë, më shumë mundësi për qytetarët dhe më shumë siguri e begati për Kosovën”, ka deklaruar ajo.



RIKTHIMI I KARNEVALEVE, POPULIZMI DHE INXHINIERËT E KAOSIT

Të gjithë së bashku, këta “inxhinierët e kaosit” po e rishpikin propagandën për epokën e selfie-ve dhe të rrjeteve sociale dhe, duke vepruar kështu, po transformojnë vetë natyrën e lojës demokratike



Më 19 shkurt 1787, Gëte ndodhet në Romë. Pasi kishte mbërritur në qytet që në ditët e para të vjeshtës, ai ishte vendosur në një apartament të zakonshëm me pamje nga Via del Corso, prej të cilit mund të sodiste, pa u vënë re, gjallërinë e arteries kryesore të qendrës historike.

Në Qytetin e Përjetshëm, poeti kishte ardhur për të kërkuar gjithçka që deri atëherë i kishte munguar në jetën e tij si enfant prodige i letërsisë gjermane, këshilltar privat i Dukës së Vajmarit, përgjegjës për minierat dhe rrjetin rrugor të dukatit: para së gjithash, lirinë për ta përdorur kohën e vet siç dëshironte.

Për të mos u bezdisur nga adhuruesit e Verterit, të cilët prej vitesh e përndiqnin kudo që shkonte, ai kishte marrë identitetin e rremë të një piktori, njëfarë Jean Philippe Möller, i cili deri në atë çast i kishte garantuar qetësinë për të cilën ndiente një nevojë aq të madhe.

Por sot poeti dëgjon një zhurmë të madhe dhe, kur përkulet nga dritarja, para syve i shfaqet një skenë e papritur: në ballkonet dhe përpara portave të pallateve përreth, banorët kanë nisur të

nxjerrin karrige dhe qilima, sikur befas të donin ta shndërronin rrugën në sallonin e shtëpisë së tyre.

Ndërkohë, në Via del Corso, drejtimi zakonisht i rregullt i lëvizjes së karrocave është përmbytur, duke shkaktuar kaos, ndërsa mes turmës kanë nisur të shfaqen disa personazhe të çuditshme.

“Djelmosha të maskuar si gra, të ngjeshur në kostume feste, me gjoksin zbuluar dhe të guximshëm deri në pafytyrësi, përkëdhelin burrat që u dalin përpara, sillen me gratë me familjaritet e pa kurrfarë konsiderate, si me të barabartat e tyre; me pak fjalë, i dorëzohen çdo lloj shthurjeje, ashtu siç ua sugjeron teka, humori apo vulgariteti.”

Në mënyrë të ngjashme, “edhe gratë kënaqen po aq duke u shfaqur me veshje burrash”, me rezultate të dykuptimta, të cilat poeti nuk ngurron t’i cilësojë “jashtëzakonisht interesante”.

“Madje, mes turmës gjendet edhe një personazh me dy fytyra: nuk kuptohet se cila është pjesa e tij e përparme dhe cila e pasme, nëse po shkon apo po vjen”.

Është fillimi i karnavaleve, festës që e kthen botën së prapthi, duke përmbytur jo vetëm marrëdhëniet mes gjinive, por edhe ato mes klasave dhe të gjitha hierarkitë që rregullojnë jetën shoqërore në kohë normale.

“Këtu mjafton një sinjal”, shkruan më tej Gëte, “për të bërë të ditur që secili mund të bëjë të çmendurin sipas mënyrës së vet dhe se, me përjashtim të goditjeve me shkop dhe therjeve me thikë, pothuajse gjithçka lejohet. Dallimi mes shtresave, mes të mëdhenjve dhe të vegjëlve, duket për një çast sikur është pezulluar; të gjithë ngjeshen pas njëri-tjetrit, të gjithë e pranojnë pa e vrarë mendjen atë që u ndodh, ndërsa liria dhe shthurja mbahen në ekuilibër nga humori i mirë i përgjithshëm”.

Në këtë atmosferë, karrocierët maskohen si zotërinj dhe zotërinjtë si karrocierë, ndërsa edhe abatët me petka të zeza, të cilët zakonisht trajtohen me nderimin më të madh, bëhen shënjestra ideale e konfeteve prej gipsi dhe argjile. Kështu, shumë shpejt, të gjorët shfaqen të

mbuluar nga koka te këmbët me njolla të bardha dhe gri. Askush nuk është i mbrojtur nga sulmet, aq më pak pjesëtarët e familjeve më të larta të shoqërisë, të cilët grumbullohen pranë Pallatit Ruspoli, pikërisht aty ku shpërthejnë sulmet më të egra dhe betejat më të përgjakshme. Ndërkohë, qindra Pulçinela, të shfaqur nga çdo anë, mbledhen në një pikë të rrugës, zgjedhin një mbret, e kurorëzojnë, i vendosin skeptrin në dorë dhe, të shoqëruar nga muzika e britmat shurdhuese, parakalojnë përgjatë Via del Corso-s mbi një karrocë të vogël të zbukuruar”. Gjithçka zhvillohet në një atmosferë gëzimi të përgjithshëm, ndonëse Gëte nuk lë pa shënuar edhe disa nota trazuese: “Jo rrallëherë”, shkruan në një çast, “përlëshja bëhet shumë serioze dhe e përgjithshme; dhe atëherë të habit egërsia dhe armiqësia personale me të cilën shfryhen të gjithë”.

Dhe më tej, teksa përshkruan garën e kuajve që zhvillohet mes dy skajeve të Via del Corso-s, ai përmend aksidentet e rënda dhe “fatkeqësitë jo të pakta, të cilat,

sidoqoftë, kalojnë pa u vënë re dhe të cilave nuk u kushtohet kurrfarë rëndësie”.

Kjo është ana e errët e karnavales: ndërthurja e pazgjidhshme e festës me dhunën, mbi të cilën mbështetet potenciali i vet përmbyës dhe që pothuajse gjithmonë lë tek ata që marrin pjesë në të, pasi është e pamundur ta vëzhgosh nga jashtë, një dyshim të fshehtë rreth natyrës së vërtetë të asaj që ka ndodhur realisht.

Sepse karnavalja nuk është një kremtim si gjithë të tjerët, por shprehja e një ndjenje të thellë dhe të papërmbytshme, që zien nën hirin e kulturës së popujve. Nuk është rastësi që, siç vëren sërish Gëte, kjo nuk është një festë që autoritetet ia ofrojnë popullit, por “një festë që populli ia ofron vetvetes”.

Asnjë pushtet nuk ka arritur ndonjëherë të çlirohet plotësisht nga karnavalja dhe fryma e saj përmbyse. Përgjatë shekujve, ajo pushoi së përshkuari rrugët për t’u zhvendosur në pamfletet dhe karikaturat e gazetave popullore, derisa u rishfaq në kohët më të fundit në satirën e komedianëve televizivë dhe në



sulmet verbale të trolleve digjitale. Por vetëm sot karnavalja e ka braktisur përfundimisht pozicionin e saj periferik, në skajet e ndërjegjes së njeriut perëndimor, për të marrë një rol qendror të paparë më parë, duke u vendosur si paradigma e re e jetës politike bashkëkohore.

...

Dhe sot, pas pamjes së çrregullt dhe groteske të karnavaleve populiste fshihet puna e ethshme e dhjetëra strategëve të komunikimit politik, ideologëve dhe, gjithnjë e më shpesh, shkencëtarëve dhe ekspertëve të të dhënave masive (Big Data), pa të cilët udhëheqësit nacional-populistë nuk do të kishin ardhur kurrë në pushtet. Të gjithë së bashku, këta “inxhinierë të kaosit” po e rishpikin propagandën për epokën e selfie-ve dhe të rrjeteve sociale dhe, duke vepruar kështu, po transformojnë vetë natyrën e lojës demokratike. Propaganda e inxhinierëve të kaosit është përkthimi politik i Facebook-ut dhe Google-it. Ajo është natyrshëm populiste, sepse, ashtu si rrjetet sociale, nuk duron asnjë lloj ndërmjetësimi dhe i vendos të gjithë në të njëjtin rrafsh, me vetëm një parametër gjykim: pëlqimet. Është indiferente ndaj përmbajtjes, sepse, ashtu si rrjetet sociale, ka vetëm një objektivi: atë që gjenitë e Silicon Valley-t e quajnë “angazhim” dhe që, në politikë, nënkupton konsensus të menjëhershëm. Ashtu si algoritmi i rrjeteve sociale është programuar për t’i ofruar përdoruesit çfarëdo lloj përmbajtjeje që mund ta mbajë pak më shpesh dhe pak më gjatë në platformë, edhe algoritmi i inxhinierëve të kaosit e shtyn atë

të mbështesë çfarëdo qëndrimi, qoftë i arsyeshëm apo absurd, realist apo ndërgalaktik, mjafton që të prekë aspiratat dhe frikërat – mbi të gjitha frikërat – e zgjedhësve. Për këta “Dr. Strangelove” të politikës, loja nuk konsiston më në bashkimin e njerëzve rreth një emëruesi më të vogël të përbashkët, por, përkundrazi, në ndezjen e pasioneve të sa më shumë grupeve të vogla, për t’i mbledhur më pas të gjitha së bashku, madje edhe pa dijeninë e tyre. Kundërtëhëniet e pashmangshme që përmbajnë mesazhet drejtuar njërit apo tjetrit grup mbeten gjithësesi, në pjesën më të madhe, të padukshme për publikun e gjerë. Në një sistem të tillë, shumica nuk fitohet më duke u afruar drejt qendrës, por duke bashkuar skajet. Dhe barrierat e vjetra ideologjike ia lënë vendin ndarjes së re mes “popullit” dhe “elitës”. Nga Brexit-i të zgjedhja e Trump-it e deri te rasti italian, sukcesi i nacional-populistëve matet me aftësinë për ta hedhur në erë ndarjen e djathtë–e majtë, me qëllim që të kapin zemërimin dhe frustrimet, ngado që ato vijnë. Ashtu si rrjetet sociale, propaganda e re ushqehet kryesisht me emocione negative, sepse janë pikërisht ato që garantojnë përfshirjen më të madhe. Megjithatë, ajo ka edhe një fytyrë gazmore e çliruese, shpesh të pavënë re nga ata që theksojnë vetëm anën e errët të karnavales populiste. Përqeshja ka qenë gjithmonë mjeti më i efektshëm për të përmbysur hierarkitë. Gjatë karnavaleve, një e qeshur çliruese varros pompozitetin e pushtetit, rregullat dhe pretendimet e tij. Asgjë nuk është më shkatërruese për autoritetin sesa një i pacipë që e shndërron

atë në objekt përqeshjeje. Përballë seriozitetit programatik të teknokratit në pushtet, mërzisë dhe arrogancës që burojnë nga çdo gjest i tij, palaçoja rebel, në stilin e Trump-it apo Grillo-s, jep një goditje kamxhiku që çliron energji. Tabutë, hipokrizitë dhe konvencionet gjuhësore shemben mes brohoritjeve të turmës në festë. Në karnavale nuk ka vend për spektatorin: të gjithë marrin pjesë në kremtimin e shfrenuar të botës së përmbysur dhe asnjë fyerje, asnjë shaka nuk është tepër vulgare për të kontribuar në rrëzimin e rendit mbizotërues dhe në zëvendësimin e tij me një dimension lirie dhe vëllazërie. Karnavalja krijon tek ata që marrin pjesë në të një ndjesi të fortë përmbushjeje, uniteti, metamorfoze dhe rilindjeje; ndjesinë se janë pjesë e një trupi kolektiv që përtërihet vazhdimisht. Secili, nga spektator, shndërrohet në aktor, pa asnjë diskriminim të bazuar në të ardhurat apo nivelin e arsimimit. Mendimi i kalimtarit të parë vlen po aq sa ai i ekspertit, madje edhe më shumë. Transferimi në Internet i karnavales prodhon efektin e çlirimit nga frenimet, i cili dikur lindte nga akti i veshjes së një kostumi. Trollet janë Pulçinelët e rinj që i hedhin benzinë zjarrit çlirues të karnavale populiste. Në këtë klimë, asgjë nuk është më e dëmshme sesa të luash rolin e atij që prish festën. Verifikuesi i fakteve, që nënvizon gabimin me lapsin blu; liberali me vetullën e ngritur, që indinjohet nga vulgariteti i barbarëve të rinj. Në sytë e populistit, progresisti është një pedant që e mban gjithmonë gishtin tregues të ngritur. Pragmatizmi i tij është

bërë sinonim i fatalizmit, ndërkohë që mbretërit e karnavales premtojnë ta kthejnë përmbys realitetin ekzistues. Jeta nuk përbëhet vetëm nga të drejta dhe detyrime, nga shifra që duhen respektuar dhe formularë që duhen plotësuar. Karnavalja e re nuk përkon me mendimin e zakonshëm, por ka logjikën e vet, më të afërt me atë të teatrit sesa me atë të auditorit akademik; më të etur për trupa dhe imazhe sesa për ide dhe tekste; më të përqendruar te intensiteti i rrëfimit sesa te saktësia e fakteve. Një arsyetim, pa dyshim, shumë i largët nga abstraksionet karteziane, por që megjithatë nuk është i zhveshur nga një koherencë e papritur, qoftë edhe vetëm për sistematicitetin me të cilin përmbys të gjitha kriteret e konsoliduara, për të afirmuar të tjera me kah të kundërt. Pas absurditetit në dukje të lajmeve të rreme dhe teorive të konspiracionit, për shembull, fshihet një logjikë shumë e qartë. Nga këndvështrimi i udhëheqësve populistë, faktet alternative nuk janë thjesht një mjet propagande. Krahastuar me informacionet e vërteta, ato kanë avantazhin se janë një mjet i jashtëzakonshëm kohezioni. “Në shumë aspekte, absurditetet janë një mjet organizativ më i efektshëm se e vërteta”, ka shkruar Mencius Moldbug, bloger i së djathtës alternative amerikane. “Çdokush mund ta besojë të vërtetën, ndërsa të besosh tek absurdi është një dëshmi e mirëfilltë besnikërie. Dhe kush ka një uniformë, ka një ushtri”. Nga ana tjetër, udhëheqësi i një lëvizjeje që i përfshin lajmet e rreme në ndërtimin e vizionit të vet për botën, dallohet nga të tjerët. Ai nuk është një burokrat pragmatik dhe fatalist si shumë

të tjerë, por një njeri i veprimit, që ndërton realitetin e vet për t’iu përgjigjur pritshmërive të mbështetësve. ...Gënjeshttrat kanë sukses sepse janë të përfshira në një narrativë politike që prek frikërat dhe aspiratat e një pjese gjithnjë e më të madhe të elektoratit, ndërsa faktet e atyre që përpigën t’i kundërshtojnë ato janë pjesë e një rrëfimi që nuk konsiderohet më i besueshëm. Në praktikë, për ndjekësit e populistëve nuk ka rëndësi vërtetësia e secilit fakt më vete, sepse ajo që është e vërtetë për ta është tërësia e mesazhit, e cila përputhet me përvojën dhe ndjesitë e tyre. Përballë kësaj, grumbullimi i të dhënave dhe i korrigjimeve do të vlejë pak, nëse vizioni i përgjithshëm i qeveritarëve dhe i partive tradicionale do të vazhdojë të perceptohet nga një numër gjithnjë e më i madh zgjedhësish, si pak i lidhur me realitetin. Për ta luftuar populizmin, duhet ta kuptojmë atë dhe jo thjesht të mjaftohemi duke e dënuar. Apo duke e hedhur poshtë si “epoka e mosarsyes”, siç bën George Osborne, ish-ministri i Ekonomisë i David Cameron. Karnavalja bashkëkohore ushqehet nga dy përbërës që nuk kanë asgjë të paarsyeshme: nga njëra anë, zemërimi i shtresave popullore, i cili mbështetet në shkaqe reale ekonomike dhe shoqërore; nga ana tjetër, një makineri e fuqishme komunikimi, e konceptuar fillimisht për qëllime tregtare dhe e shndërruar më pas në mjetin e parapëlqyer të të gjithë atyre që duan ta shumëfishojnë kaosin. Shkëputur nga libri “Inxhinierët e Kaosit”, i Giuliano Da Empoli

Bota.al



EURO GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Montim
Servisim
Parket



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Zhegrova ia bën sefte me Juventusin

SASSUOLO, 14 SHTATOR - Ylli i Kosovës Edon Zhegrova më në fund ka shënuar në Serinë A. Zhegrova ka shkëlqyer

ndaj Sassuolos, duke shënuar dy gola, por ekipi i tij ka humbur 3-2. "SofaScore" si zakonisht ka publikuar notat

e lojtarëve, ku ylli i Kosovës pas dy golave ka qenë më i dalluari me notën 9.3. Edhe Aro Muriqi, i cili luan për

Sassuolon, ka pasur një paraqitje fantastike. Ai ishte më i dalluari te Sassuolo me notën 8.2.



SHTYHET FINALJA E SUPERKUPËS SË KOSOVËS NË BASKETBOLL



PRISHTINË, 14 SHTATOR - Finalja e shumëpritur e ProCredit Superkupës së Kosovës në basketboll është shtyrë për dy javë, ka njoftuar Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK). Finalja ndërmjet Trepçës dhe Bashkimit, e paraparë të zhvillohej sot (e martë) nga ora 19:00 në Palestrën Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec, nuk do të zhvillohet në datën e planifikuar.

Bordi i FBK-së ka miratuar kërkesën zyrtare të komunës së Rahovecit për shtyrjen e ndeshjes, e cila është parashtruar për arsye teknike dhe organizative, me qëllim të sigurimit të kushteve të nevojshme për organizimin dhe mbarëvajtjen sa më të mirë të finales. Sipas vendimit të Bordit të FBK-së, finalja do të zhvillohet më 29 ose 30 shtator 2026, po në

Palestrën Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec. Data dhe ora përfundimtare e finales do të përcaktohen pas koordinimit të FBK-së me komunën e Rahovecit dhe KB Rahoveci 029, ndërsa do t'i komunikohen me kohë opinionit publik. FBK-ja ka konfirmuar se të gjitha biletat e blera për finalen e paraparë për sot do të mbeten të vlefshme edhe për datën e re të zhvillimit të ndeshjes.

PRISHTINA VAZHDON SERINË E FITOREVE

Prishtinë, 14 shtator - Drita dhe Gjilani janë ndarë në paqe në derbin e madh të Anamoravës në kuadër të javës së gjashtë në Albi Mall Superligë. Ndeshja e zhvilluar në Gjilan ka përfunduar 0:0 pavarësisht prej rasteve të krijuara nga të dyja skuadrat. Rastin më të mirë të ndeshjes e ka pasur Gjilani në pjesën e parë, kur Robert Rrahmani është gjendur në pozitë të favorshme, por dy tentimet e tij janë ndalur nga portieri i Dritës, Faton Maloku. Ky ishte barazimi i dytë për kampionen e Kosovës, e cila deri tani ka

regjistruar edhe dy fitore dhe një humbje. Me një ndeshje më pak të zhvilluar, Drita ka 8 pikë dhe renditet në vendin e gjashtë. Gjilani, në anën tjetër, ka regjistruar barazimin e dytë të sezonit. Me tri fitore dhe një humbje, skuadra gjilanase ka grumbulluar 11 pikë dhe vazhdon të jetë në pjesën e sipërme të tabelës. Ndërsa në Klinë, Prishtina ka regjistruar fitoren e pestë radhazi në kampionat, duke mposhtur Feronikelin 74 me rezultat 3:0. Ndeshja, e zhvilluar në stadiumin "18 Qershori",



është zhbllokuar në minutën e 33-të. Assane Diatta, pas asistimit të Arijanit Fazlijës, ka realizuar një gol spektakolar me goditje gërhërë për epërsinë 1:0. Prishtina e ka dyfishuar avantazhin në minutën e 61-të.

Këtë herë ishte Fazlija që ka shënuar me kokë pas harkimit të Albin Krasniqit. Fitoren bindëse të prishtinasve e ka vulosur sërisht Diatta në minutën e 92-të, duke realizuar golin e tij të dytë në këtë takim dhe të tretin për skuadrën. Me këtë fitore Prishtina kryeson tabelën me 15 pikë, ndërsa ka edhe një ndeshje më pak të zhvilluar. Feronikeli 74 mbetet në pozitën e parafundit me 3 pikë. Kurse Drenica ka arkëtuar pikët e plota për herë të parë këtë sezon, duke e mposhtur Vushtrrinë me rezultat 0-3.

Drenica ishte më e mirë nga fillimi, me Altin Vojvodën që ka kaluar mysafirët në epërsi pas asistimit të Limanit në minutën e 13-të. Ndërkohë, Donat Mehmeti ka shënuar një gol të bukur për ta dyfishuar epërsinë në minutën e 78. Krejt në fund fitoren e mysafirëve e ka vulosur Osman Mëziu, duke realizuar nga pika e bardhë në minutën e 89. Pas këtij triumfi, Drenica ngjitet në pozitën e shtatë me gjashtë pikë, ndërsa Vushtrria vazhdon të jetë klubi i vetëm në elitë që ende nuk ka arritur as edhe një pikë.

AMERIKANET SHPALLEN KAMPIONE TË BOTËS PËR HERËN E PESTË RADHAZI

BERLIN, 14 SHTATOR - Asnjë surprizë në finalen e Kupës së Botës në basketboll për femra. ShBA-ja ka përmbysur Francën në pjesën e dytë dhe k siguruar një tjetër titull të madh, duke vazhduar dominimin në skenën ndërkombëtare. Amerikanet kanë triumfuar 97-79 ndaj Francës në finalen

e zhvilluar në Berlin, duke e mbyllur turneun me medaljen e artë për të pestën herë radhazi. Ky ishte titulli i 12-të i ShBA-së në historinë e Kupës së Botës. Në qendër të suksesit amerikan ishte Breanna Stewart. Ajo ka realizuar 22 pikë, 10 kërcime dhe katër asistime, duke regjistruar një



double-double dhe duke udhëhequr skuadrën drejt titullit. Për Stewart, ky ishte

titulli i katërt i Kupës së Botës në karrierë. Ajo është shpallur gjithashtu MVP e turneut, duke e fituar këtë çmim për herë të dytë në një Kupë Bote. Finalja e Berlinit ishte një tjetër kapitull i rivalitetit mes ShBA-së dhe Francës. Dy skuadrat ishin përballur edhe në finalen e Lojërave Olimpike të Parisit në vitin

2024, ku amerikanet kishin fituar me vetëm një pikë, 67-66. Me këtë triumf, ShBA-ja ka konfirmuar edhe një herë statusin e saj si forca kryesore e basketbollit botëror për femra. Amerikanet tashmë kanë 36 fitore radhazi në Kupën e Botës, me humbjen e fundit në këtë garë që daton nga viti 2006.

Shqipëria pa Uzunin në Ligën e Kombeve

TIRANË, 14 SHTATOR - Sulmuesi Myrto Uzuni pritet të mungojë në listën e selektorit të Kombëtares së Shqipërisë, Rolando Maran, për ndeshjet e këtij muaji në kuadër të Ligës së Kombeve. Shqipëria pritet që gjatë kësaj jave ta publikojë listën e

futbollistëve të ftuar, por Uzuni nuk pritet të jetë pjesë e saj për shkak të dëmtimit në këmbë. Uzuni nuk ka luajtur në tri javët e fundit për Austin FC, ndërsa ka munguar edhe në ndeshjen e fundit ndaj Colorado Rapids. Sipas raportimeve të fundit, ai është ende në fazën e


rikuperimit dhe mbetet e paqartë nëse do të jetë në gjendje të rikthehet në kohë për ndeshjet e kombëtares. Për këtë arsye Maran mund të mos llogarisë në shërbimet e sulmuesit për dy ndeshjet e para të Shqipërisë në Ligën e Kombeve. Shqipëria do të

përballet me Bjellorusinë më 26 shtator, ndërsa më 29 shtator do të luajë ndaj San Marinos. Mungesa e Uzunit do të ishte një tjetër problem për Maranin, pasi sulmuesi kishte fituar vendin e titullarit në ndeshjet e fundit të Kombëtares.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinese.com
www.pallatirinese.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L -087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ckipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/c Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomë nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data **11.09.2026 deri më 10.10.2026**

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinese.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinese.com/> ose mund të merren në zyrë të Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Halë Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme “Remzi Ademaj” Prizren, diplomën dhe dëftesën e provimit.

- Bosnalijek farmaceutska i Hemijska Industrija dionicko Društvo Kosova Branch Dega në Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810122309.

- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.

- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmua “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.

- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.f.m.u “Ahmet Rustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.


- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća

Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficient: 5.9

2. **Generalni savetnik - Sekretar preduzeća** ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetSKU diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

* Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posjedovati dobre komunikacijske vještine;
- Posjedovati radnu etiku i integritet.
- Posjedovati računarske vještine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/1.-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 061-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026.

Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni.

Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u užu izbor.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

